

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ARVENICA" Sh.P.K

Sot, me daten **02.10.2024** shtetasit shqiptare:

1-Z. Nertin Haruni, shtetas shqipëtar , lindur më 21 Korrik 1988 në Vlore, Shqipëri mbajtes i kartes se identitetit me nr.036098442 dhe nr.personal I80721102D , me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

dhe

2-Z. Fatjon Lulaj, shtetas shqipëtar, lindur më 27 Tetor 1983 ne Vlore, Shqipëri, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 038562256 dhe nr. personal I31027076P me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

vendosen te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **"ARVENICA" sh.p.k;** mbeshtetur ne nenin 2, paragrafi "B", i Ligjit "Per sanksionet dhe mbrojtjen e prones private dhe nismes se lire te veprimtarise private, te pavarur dhe te privatizimit", ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ne te cilen ata jane Ortake te shoqerise dhe per kete qellim hartojne Aktin e Themelimit te Tij, me permbajtjen si vijon:

NENI 1

EMRI

Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet **"ARVENICA" Sh.P.K** , e cila ketu e me poshte do te quhet "shoqëria".

NENI 2

FORMA

Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar.

NENI 3

BAZA JURIDIKE

Shoqeria krijohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne përputhje me kete legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 4

SELIA

Selia e shoqerise do te jete ne **L. 1 Maj, Rruga Miss Durhan, banese 1 kateshe Nr.52 , Vlore** dhe mund te ndryshoje adresen e selise se saj vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.


NENI 5

TERRITORI

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne territorin e Republike se Shqiperise si dhe jashte saj. Shoqeria mund te krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera, ne përputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISE



Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Tregeti me shumice dhe pakice e produkteve ushqimore dhe industriale, elektroshtepiake, elektrike, pjese kembimi, materiale ndertimi, etj. Import-Eksport mallra te ndryshem.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet licensa perkatese, shoqëria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete license nga organet kompetente.

NENI 7

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit, me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara me ligj ose me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 8

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 000 (Njeqindmije) Leke. Ky kapital eshte i ndarë ne 2 kuota nga 50,000 Leke secila, te zoteruara nga ortakët e shoqerise ne masen 50% secili . Kapitali eshte teresisht i nenshkuar i shlyer.

NENI 9

KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i Ortakve të vetëm të Shoqerise ne vleren prej 100 000 (Njeqindmije) Leke.

NENI 10

PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte i perbere prej 2 kuotash, plotesisht te shlyera, me vlere nominale 50 000 (Pesdhjetemije) Leke per nje kuote.

NENI 11

ADMINISTRIMI

Administrimi i Shoqerise do te behet nga nje administrator. Administrator i shoqerise eshte Z. Nertin Haruni. Ai e ushtron kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

NENI 12


DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria do te rregullohet, pervec ketij Akti Themelues edhe me norma te percaktuara ne Statutin e saj, i cili do te nenshkruset nga ortakët dhe si i tille do te miratohet ne Qendren Kombetare te Biznesit ditën e legalizimit si person juridik ne Shqiperi.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 4 (kater) kopje, ne gjuhen shqipe, duke patur secila fuqi te njejte ligjore.

THEMELUES

Z. Nertin Haruni



Z. Fatjon Lulaj

